



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji”

ofruar nga

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Ass.Dr. Anisa Subashi

2. Prof.Ass.Dr. Eralda Zhilla

Janar, 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në "Psikologji" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Psikologji"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MAS nr. 4276 prot., datë 01.07.2004
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 387, datë 30.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE dhe 6 PAK
18	Numri i studentëve:	37 38 26
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" është një program studimi, i cili ofrohet prej vitit 2004 dhe ka si qëllim kompletimin e studentëve me kompetenca profesionale dhe personale; me njohuri dhe aftësi në orientime të ndryshme të fushës së psikologjisë, si psikologji sociale, klinike, organizacionale, etj. Kjo perspektivë e programit të studimit krijon mundësinë që studentët të jenë të orientuar qartazi në përzgjedhjen e karrierës së tyre të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.


Ky program studimi është program i studimeve të ciklit të parë të studimeve universitare, me një nivel të studimeve 6 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, me studime me kohë të plotë, me 180 kredite, duke formuar Psikologë të Përgjithshëm. Njësia akademike që e ofron atë është njësia kryesore: Fakulteti i Shkencave të Edukimit, si pjesë e institucionit të Universitetit të Shkodrës dhe njësia bazë është Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale.

Kjo kurrikul kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin Shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen.

Misioni i programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" është: Të stimulojë e të çojë në një nivel edhe më të lartë mendimin kritik nëpërmjet krijimit, zhvillimit dhe përcjelljes së dijeve, duke kontribuar në profilizimin gjithnjë e më të dallueshëm e profesional të profesionit të psikologut në shoqërinë shqiptare; Të lidhë fuqishëm e qartazi anën teorike me aftësimin praktik për të formuar studiues, psikologë dhe specialistë të lartë në fushën e psikologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; Të ofrojë një proces koherent edukues e arsimor për studentët, të cilët do të vazhdojnë kualifikimin në nivelet e tjera të studimit të profilizuar në fushën e psikologjisë; Të ofrojë një program mësimor konkurrues bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikula bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësinë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe dhe është i organizuar në lëndë dhe module lëndore sipas tipeve të veprimtarive formuese të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin European të transferimit dhe të grumbullimit të krediteve (ECTS). Në përfundim të programit të studimeve studentët pajisen me diplomën Bachelor në "Psikologji" dhe me suplementin përkatës.

Kurrikula e programit të studimit është hartuar dhe organizuar në përputhje me zhvillimet e fushës dhe në përgjigje të interesave dhe nevojave kombëtare. Gjatë zhvillimit të programit të studimit ofrohet literaturë e pasur në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, duke mundësuar ndërthurjen e përvojave studimore vendase dhe ndërkombëtare të fushës së studimit në psikologji.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Kreu X: Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, mbështetur në VKM nr. 109 për organizimin e ASCAL dhe në Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017, për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit Bachelor në “Psikologji” ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit Prof. Asoc. Dr. Eralda Zhilla dhe Prof Asoc Dr Anisa Subashi. Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm grupi i ekspertëve është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Aleksandra Xhamo.


Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në data 29-30 qershor 2023. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht Univeristetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër sipas parashikimeve të akteve rregullatorë të ASCAL.

GVJ ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme RVB-në dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përpara vizitave në institucion në mënyrë që të zhvillonte një takim të mirëinformuar paraprakisht me aktorët e programit të studimit. Gjatë vizitës dy ditore (29-30 qershor 2023) në Univeristetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH) u mbajtën takime me drejtuesin e njësisë kryesore dhe drejtuesin e njësisë bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Drejtorisë së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, me përfaqësues të Drejtorisë së Kooordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, me përfaqësues të drejtorisë së burimeve njerëzore, gjithashtu u zhvilluan vizita në mjedise të FSHE dhe USH si në biblioteka, mjedise studimi, auditore, laboratorë, në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj.



Më datë 04.12.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 221/49 Prot., datë 04.12.2023, dërgohet në institucion Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 12.12.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 3931/1 Prot., datë 19.12.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.


Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakortësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Psikologji” në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është institucion publik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili në misionin e tij ka të përcaktuar qartë orientimin e veprimtarisë së tij për formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar duke kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare. Në Statutin e Universitetit të Shkodrës (2018), neni 4: Misioni deklarohet se: “Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër si institucion i arsimit të lartë ka për mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimit Bachelor në “Psikologji” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në planin strategjik institucional (<i>Evidencë I.1 Statuti USh</i>) dhe me misionin e institucionit Referuar RVB-së, programi i studimit është në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë dhe të kombit shqiptar, në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në “Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë”. Programi i studimit iu siguron studentëve aftësi akademike dhe etike të nevojshme që mund t’i ndihmojë ata të jenë në gjendje të kontribuojnë në mjedisin kërkimor në Shqipëri dhe në zhvillimin e tyre profesional. (<i>Evidencë I.1</i>)
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së Njësisë bazë dhe Njësisë kryesore. Në dokumentat themelore të programit të studimit Bachelor në “Psikologji” dëshmohej se programi është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me qëllimin dhe misionin e USH. Universiteti Shkodrës ofron programe studime të cilat janë në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” synon që të formojë profesionistë të kualifikuar në fushën e psikologjisë si edhe të rrisë vetëdijen qytetare dhe morale tek studentët duke reflektuar vlerat më të larta morale dhe etike në shërbim të grupeve vulnerablë në veçanti dhe shoqërisë Shqiptare në tërësi. Në rregulloren e departamentit (2020), Misioni deklarohet se: “Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale” në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka si qëllim të përmirësojë kurrikulat ekzistuese sipas kërkesave dhe



	<p>zhvillimeve të reja shoqërore dhe tregut të punës; Të zhvillojë aktivitete kërkimore; Të monitorojë ecurinë e secilit prej programeve dhe ti vlerësojë ato.</p> <p><i>(Evidencë 1.3 Rregullore FSHE, Departamenti dhe programi)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është hartuar dhe ofrohet në zbatim dhe në përshtatje me strategjinë për zhvillim institucional të USH, të rregullores së organizimit dhe të funksionimit të USH, të rregullores së studimeve në USH dhe në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.</p> <p>Përmbushja e këtij kriteri në ofrimin e programit Bachelor në “Psikologji” duket qartë në koherencën dhe kohezionin e vizionit, qëllimit dhe objektivave të ofrimit të programit të studimit, të cilat ndërtohen në frymën e zhvillimit të strategjisë institucionale dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullative të USH</p> <p>Rregullorja e FSHE-së dhe Statuti USH-së vijnë në të njëjtën linjë dhe përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike, si dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të tij.</p> <p>Sipas Statutit të USH (2018), neni 9 në Strukturën e USH bën pjesë Fakulteti Shkencave të Edukimit ku ndodhet dhe njësia bazë e Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale, e cila ofron edhe programin e studimit Bachelor në “Psikologji”. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Statutin e USH neni 52 dhe rregulloren e studimeve në USH ku thuhet që programet e ciklit të parë organizohen me jo më pak se 180 kreditë dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të mesatares, e cila përcaktohet në rregullore.</p> <p><i>(Evidencë 1.1 Statuti USH)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Duke qenë se profesioni i psikologut është në listen e profesioneve të rregulluara mund të argumentojmë se ende ka nevojë për përfshirjen e psikologut në shërbimet publike dhe private në vend. Në këtë perspektivë programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe prirjet globale.</p> <p>Për të plotësuar nevojat e tregut, programi i studimit Bachelor në “Psikologji” ofron lëndë mësimore që ndikojnë në formimin e përgjithshëm të studentëve dhe duke krijuar rrugën që në të ardhmen, pas studimeve master, këta studentë të jenë një vlerë e shtuar në sektorët socialë dhe ekonomikë të vendit.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit është një dokument themelor për programin e studimit, i cili justifikon qëllimin e hartimit të programit dhe reflekton se programi i studimit përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe në fushën e profesioneve të rregulluara, sikurse është profesioni i psikologut. Kjo rregullore është në përputhje edhe me Statutin e Universitetit dhe i referohet çdo hallke të programit.</p> <p><i>(Evidencë 1.3 Rregullore FSHE, Departamenti dhe programi)</i></p>

<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Psikologji” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka orientuar veprimtarinë e tij duke ofruar mësimdhënie cilësore, duke punësuar staf akademik të përkushtuar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe në projekte të ndryshme, si edhe ndërtimin e marrëdhënieve me organizata vendase dhe të huaja, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, kryerjen e projekteve/detyrave të kursit, studime kërkimi. Programi i studimit është konform rregullave dhe direktivave kombëtare e evropiane. <i>(Evidencë 1.1 dhe Evidencë 1.3)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Referuar dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë rezulton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Në hartimin dhe politikën e zhvillimit të programeve të studimit synohet zhvillimi i interesave dhe vlerave kombëtare si dhe ruajtja e tyre. Programi i studimit Bachelor në “Psikologji”, ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në Fakultetin e Shkencave të Edukimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi akademik dhe administrativ i USH-së dëshmon rëndësinë e marrëdhënieve bashkëpunuese në nivele të ndryshme të organizimit brenda institucionit për mbarëvajtjen e programit të studimit bachelor në psikologji.</p> <p>Fryma e bashkëpunimit shprehet nëpërmjet ndarjes së detyrave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në funksion të mbështetjes së punës së programit të studimit.</p> <p>Ndarja e detyrave mes njësisë e personelit dhe marrja e përgjegjësisë përkatëse planifikohet që në fillim të vitit akademik, duke siguruar realizimin me sukses të procesit mësimor, praktikave, udhëheqjeve të diplomave dhe veprimtarive të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor e kërkimor të programit të studimit. Njësitë bazë dhe personeli akademik i tyre ofrojnë ekspertizën e tyre në përmbushje të kuadrit të veprimtarisë në programin e studimit Bachelor në “Psikologji” ashtu sikurse edhe personeli akademik i departamentit ofron ekspertizën e tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës në njësi të tjera bazë të njësisë kryesore të USH-së.</p> <p><i>(Evidencë 1.3 dhe Evidencë 1.11)</i></p>

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimit me institucione synohet: “të rritet bashkëpunimi jashtë USH-së duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me interes të përbashkët me të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik në Shqipëri si Universiteti i Tiranës, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Firences, bashkitë, drejtoritë rajonale, ministrinë etj. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit përmban rreth 17 institucione vendase, ndër të cilat mund të përmendim:</p> <p>Universiteti i Tiranës Universiteti i Elbasanit Universiteti i Firences Bashkia Shkodër Urdhëri i Psikologut Gjykata rrethit Shkodër Spitali rajonal Shkodër OJF the Door Alternativa pro e shumë të tjerë. <i>(Evidencë 1.9, Evidencë 1.10 dhe Evidencë 1.14)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale për të cilat Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër vendos në dispozicion një listë me rreth 17 marrëveshje me institucione në të cilat studentët mund të kryesojnë praktikat profesionale varësisht profileve të tyre të studimit. Në listë mund të veçojmë institucione të rëndësishme për praktikat profesionale të programit të studimit si më poshtë:</p> <p>Bashkia Shkodër Shërbimi i provës Zyra vendore Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër Drejtoria rajonale e shërbimit social Shkodër Organizata “Gruaja tek Gruaja” Urdhëri i Psikologut <i>(Evidencë 1.9, Evidencë 1.10 dhe Evidencë 1.14, Evidencë 2.13)</i></p> <p>Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dëshmojnë se në veprimtaritë e tyre kërkimore shkencore bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushave të ndryshme. Disa veprimtari kërkimore të realizuara në bashkëpunim janë:</p> <p>Kampionati debatit dhe konferenca studentore Konferencat e organizuara nga USH ndër vite <i>(Evidencë 3.2 dhe Evidencë 3.7)</i></p> <p>Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme mobiliteti nga të cilat përfitojnë personeli akademik dhe studentët. Universitet “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dëshmojnë se si programin kryesor me anë të të cilit mundësohet mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik është ERASMUS+. <i>(Evidencë 3.3)</i></p>

Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, ku ofrohet programi i studimit Bachelor në “Psikologji” harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto të dhëna pasqyrohen në dokumeta si raporti vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, raporti për veprimtarinë e programit të studimit, analiza vjetore e departamentit e të tjerë. (Evidencë 1.11)			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti i Shkodrës ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. GVJ sugjeron që Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit, pasi nuk ka asnjë student përfitues shkëmbimesh nga programi i studimit nën akreditim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu VII, neni 71 pika 2 dhe 3 shprehet si më poshtë: “Pika 2; Elementet që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” “Pika 3; Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statut dhe rregullore elemente të hollësishme për programet e studimeve që ato ofrojnë.” Sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, duhet të jenë sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2, shprehet se: Elementet që

	<p>përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</p> <ol style="list-style-type: none"> kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; objektivat formues dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; planin mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; programin lëndor (Syllabus-et); profilin e programit; diplomën dhe suplementin; <p>Programi i studimit është i hartuar dhe licensuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programet e studimit në ciklin e parë janë të organizuar në lëndë/module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ato realizohen në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është i organizuar dhe ofrohet me të gjithë elementët e tij në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi sipas niveli 6 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve <i>(Evidenca 1.1, Evidenca 1.3 dhe Evidenca II)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Hartimi i programit të studimit, syllabusve të lëndeve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit burojnë nga kuadri ligjor për Arsimin e Lartë; Statuti dhe Rregullore të Universitetit të Shkodrës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e psikologëve.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër Fakultetin e Shkencave të Edukimit/Departamentin e Psikologjisë dhe Punës Sociale ka si qëllim kompletimin e studentëve me kompetenca profesionale dhe personale; me njohuri dhe aftësi në orientime të ndryshme të fushës së psikologjisë, si psikologji sociale, klinike, organizacionale, etj. Kjo perspektivë e programit të studimit krijon mundësinë që studentët të jenë të orientuar qartazi në përzgjedhjen e karrierës së tyre të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>
	<p>Kjo kurrikul e Studimeve në Ciklin Bachelor në “Psikologji” kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin Shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një zgjedhje më të informuar në të ardhmen.</p>

	<p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale synon që përmes programeve të studimit t'i orientoje studentët drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës. Studentëve, krahas njohurive në disiplinën karakterizuese të studimit ju ofrohen dije dhe kompetenca edhe në disiplina të përfaqësuara duke synuar kultivimin e kompetencave të nevojshme për të përgatitur profesionistë të specializuar në shërbim të komunitetit.</p> <p><i>(Evidenca I dhe Evidenca II)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program studimi ka të përcaktuar qartë se dijet dhe njohuritë e përvetësuara në të janë të orientuara drejt përvetësimit të koncepteve bazë psikologjike, teorive klasike dhe analizave kryesisht makro e mikropsikologjike bazuar mbi paradigmen e zhvillimeve psikosociale të qenies njerëzore në disa drejtime. Lidhja e ngushtë e dijeve psikologjike me kontekstin bashkëkohor, teorinë dhe paradigmat e sipërpërmendura orientojnë zhvillimin e kompetencave për hulumtimin e dinamikave psikologjike në një premisë kryesisht shumë holistike. Ky program studimi i orienton studentët edhe drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës. Thuhet gjitha lëndët e këtij programi në nivel universitar janë të pajisura me tekstet përkatëse origjinale ose të përkthyer ose leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës. Në to studentët gjejnë parashtrimet themelore për lëndën. Përpos teksteve, studentëve iu referohet literaturë plotësuese në gjuhën Shqipe ose në shumë pak raste në gjuhën angleze.</p> <p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është me 180 kredite dhe me klasifikimin sipas komponentëve mësimorë për secilën lëndë të planit mësimor.</p> <p><i>(Evidenca 1.1 dhe Evidenca 2.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit rezulton se në programin e studimit Bachelor në “Psikologji” ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës 10 kredite në planin mësimor, të emërtuar Praktikum. Në planin mësimor kjo lëndë zhvillohej gjatë vitit të tretë në semestrin e parë dhe të dytë, duke i caktuar një ngarkesë prej 4 orë seminari në javë. Gjatë vizitës në institucion me pedagogun e lëndës dhe studentët u diskutua që kjo lëndë të riemërtoj sipas funksionit që ajo kishte.</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë Kreu III, Seksioni I, Neni 17: Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë, pika 5 përcaktohet se: “Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, gëzojnë status të veçantë. Ky status i jepet institucionit të arsimit të lartë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.”</p> <p>Sipas këtij përcaktimi, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër nuk është Institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.</p> <p><i>(Evidencë II)</i></p>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Lëndët në këtë program studimi kanë ngjashmëri edhe me programet e tjera në universitete brenda dhe jashtë vendit. Kjo krijon më shumë mundësi për transferime apo mobilitet të studentëve. (Evidencë 1.1)</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022 për “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, pika 12 theksohet se: “Për programet e studimit ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre”. Nga shqyrtimi dokumentacionit vihet re që programet janë të gjitha sipas kodeve përkatëse. (Evidencë 1.1 dhe Evidencë 2.2)</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Në Statutin, Strategjinë e zhvillimit Institucional dhe në Rregulloren e studimeve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër parashikohet edhe rëndësia e programeve të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi studimi Bachelor në “Psikologji” nuk është një program i përbashkët studimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Referuar konstatimeve të mësipërme, GVJ e vlerëson të përmbushur plotësisht këtë standard, por duke caktuar dy rekomandime bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Riorganizim të programit të studimit Bachelor në Psikologji për të lehtësuar peshën në orë dhe kredite për lëndët që janë me ngarkesë të madhe; 2. Reformulim dhe riorganizim të praktikës mësimore 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë përcaktohen qartë detyrimet e njësisë kryesore dhe njësisë bazë në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike si më poshtë vijon: Në Nenin 23 të Ligjit përcaktohet se: “Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë”. Në Nenin 25 të ligjit përcaktohet se Departamenti: “Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe</p>



	<p>grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në përcaktimet e mësipërmë GVJ konstaton se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, Fakulteti i Shkencave të Edukimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Fakulteti Shkencave të Edukimit ka në strukturën e tij 42 pedagogë efektiv gjithsej, nga të cilët 11 i përkasin Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale. Nga këta 11 individë, një është me titull Profesor i Asociuar, 9 janë me gradën Doktor dhe një me Master Shkencor. Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale rezulton se në vitin e fundit akademik ka patur 8 personel akademik të angazhuar me kohë të plotë në fushën e psikologjisë (PAE) dhe 6 personel akademik me kontratë (PAK). Nga PAE në DPPS rezulton se: 1 pedagog është i kategorisë Prof. Asoc. Dr.; 7 pedagogë janë të kategorisë Dr. Nga PAK në DPPS gjatë vitit të fundit akademik rezulton se: 5 pedagogë janë të kategorisë Msc dhe 1 është i kategorisë Dr.</p> <p><i>(Evidencë 1.7)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, në planin e tij mësimor ka të paraprirë zhvillimin e praktikës institucionale të emërtuar si Praktikum. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel akademik efektiv për realizimin e praktikave institucionale. Praktikë institucionale janë të rregulluara gjithashtu nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione me fushë veprimi në dobi të programit të studimit dhe modalitetet e vlerësimit gjatë praktikës janë përcaktuar në programin e bursës hartuar nga drejtuesja e praktikës caktuar nga departamenti.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me studentët e stafin akademik, identifikoi ndryshimin e emërtimit të kësaj lënde duke e fokusuar në praktikë aktive në terren. Studentët shprehen që nuk janë të mirëorientuar lidhur me praktikën jashtë ambjenteve të fakultetit. Ata kërkojnë një angazhim aktiv në terren, dhe jo zhvillimin si lëndë Praktikum. Mënyra si ishte konceptuar në plan program kërkonte angazhim dhe pjesëmarrje periodike të studentëve në takimet në auditor. Ndërkohë GVJ rekomandon që kjo lëndë të riemërtohet “Praktikë” dhe të ketë fokus praktik për studentët, në qendra dhe institucione në zonat përreth.</p> <p><i>(Evidenca 1.10 dhe Evidenca 1.4)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale në nenin 6 të saj parashikohet përgjegjësi i departamentit si autoritet</p>

<p>program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>drejtues akademik për këtë program studimi. Ai është përgjegjës për të gjithë mbarëvajtjen e ecurisë dhe zhvillimit të planin mësimor, kërkimi shkencor, praktikat profesionale e më gjerë. Referuar ngarkesës që ka përgjegjësi departamentit, GVJ rekomandon që në cilësinë e koordinatorit të programit të studimit të caktohet një anëtar i personelit akademik efektiv, i cili do jetë përgjegjës për ecurinë e programit dhe do jetë në kontakt të vazhdueshëm me përgjegjësin e departamentit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale si njësi përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Psikologji" përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Ndërkohë për këtë program studimi kërkohet caktimi i një koordinatori për programin e studimit në funksion të realizimit të objektivave të tij dhe të drejtimit të praktikave profesionale nga personel akademik. Aktualisht kjo gjë bëhet nga përgjegjësi i departamentit, por referuar ngarkesës që ai ka GVJ rekomandon caktimin e një personi tjetër. Gjtitashu edhe praktikat profesionale duhen riemërtuar dhe fokusi të jetë punë praktike në terren.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti luan një rol të madh dhe është përgjegjës në organizimin e stukturës dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Njësia disponon informacione nëpërmjet ngarkesës mësimore, planit të punës dhe programin e aktiviteteve të programit Bachelor në "Psikologji".</p> <p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarinë administrative. Struktura e programit të studimit paraqitet në nenin 8 të rregullores së studimit.</p> <p><i>(Evidencë II).</i></p> <p>Ky Departament ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ku organizimi, struktura dhe përmbajtja e këtyre programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimit akademike të tij, si edhe në përputhje të plotë me klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës.</p> <p>Departamenti është njësi bazë e mësimdhënies dhe punës shkencore si dhe është përgjegjës për programin që ofron.</p> <p><i>(Evidenca 1.3)</i></p> <p>Çdo program studimi në Fakultetin e Shkencave të Edukimit ka rregulloren e tij. Rregullorja e programit të studimit hartohet nga</p>

	<p>departamenti përgjegjës për programin e studimit dhe miratohet në Senatën Akademik me programin përkatës të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” është një dokument i përshtatshëm për të orientuar informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit për aktorët e përfshirë në këtë program studimi dhe përmban 180 kredite.</p> <p><i>(Evidencë 1.1)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale harton plane mësimore ku përfshihen informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor, mënyrat e vlerësimit të dijes etj. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Psikologji” përmban planin mësimor ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor /jashtë auditorit.</p> <p>Në dokumentin e Rregullores së programit të studimit Bachelor në “Psikologji” përcaktohen të gjitha modalitetet dhe rregullat e informacionet e nevojshme për programin e studimit, që nga kriteret e pranimit dhe deri në detaje mbi literaturën e lëndëve, shlyerjen e detyrimeve dhe të tjera kushte për frekuentimin e programit.</p> <p>Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjërë informativ, në të cilin paraqiten elementë si: kreditet për çdo veprimtari formuese, ngarkesa në auditor dhe ajo jashtë auditorit.</p> <p>GVJ konstaton se praktika profesionale është shpërndarë në planin mësimor nën emrin e lëndës Praktikum, në vitin e tretë me ngarkesë javore 4 orë seminari në semestrin e parë dhe në semestrin e dytë e njëjta gjë. Në çdo rast kjo shpërndarje në planin mësimor bie ndesh me Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” pika II.12 e) sipas të cilit një ditë pune në praktikë është 5 orëshe. Gjatë vizitës në institucion GVJ e konstatoi këtë problematikë dhe vuri në dijeni përgjegjësin e departamentit. Në planin mësimor duhet të reflektohet menjëherë praktika profesionale në vend të asaj që është aktualisht.</p> <p><i>(Evidenca 1.3, Evidenca 1.1 dhe Evidenca 2.1)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Departamenti përmban të gjitha informacionet mbi transferimin, ekuivalentimin, dhe pranimin e studimeve. Fakulteti ka të përcaktuar në Rregulloren e tij edhe transferimet e studentëve, në të cilën janë të përcaktuara kriteret si ato të përgjithshme, ashtu dhe ato specifike për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Kjo bëhet nëpërmjet vendimit të ekuivalentimeve dhe transferimeve duke u bazuar edhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, në nenin 20 dhe 21 të saj. <i>(Evidencë 2.4)</i></p> <p>Transferimi ndërmjet programeve kryhet në përputhje me politikën e Universitetit të Shkodrës, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Shkodrës. Studentët që ndjekin Programin Bachelor në “Psikologji” mund të transferohen në një program të tjetër me kërkesë të tyre nëse është e lejueshme në varësi të kriterëve dhe rregullave të çdo programi studimi.</p>



	<i>(Evidencë II)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dëshmon nëpërmjet dokumentacionit shoqërues të RVB-së se mban në mënyrë sistematike dosjen e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” në të cilën gjenden informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, seminarët apo leksionet, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me VKM 41, të ndryshuar.</p> <p>Programi i studimit përmban të gjitha syllabuset e detajuara si dhe formatet e miratuara. Sipas rregullores së DPPS është përgjegjësi e njësisë bazë, si dhe titullarit të lëndës përkatëse që ka ngarkesën në programin respektiv për të vlerësuar dhe përditësuar syllabusin e programit për vitin e ri akademik.</p> <p><i>(Evidencë 2.3 dhe Evidencë 2.6)</i></p>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Sipas rregullores së programit të studimit Bachelor në “Psikologji” para fillimit të vitit të ri akademik bëhet rishikimi i programeve të studimit, i cili synon të korrigjohen problemet që janë ndeshur gjatë procesit mësimor, të përmirësohen dhe përditësohen elementë të ndryshëm të programit të studimit. Departamenti ka të arkivuara dosjet si dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme ndryshimet, të cilat janë të evidentuara edhe në procesvebalin e departamentit, thuhet gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Ndryshimi i përmbajtjes së programit të studimit gjatë takimeve në institucion me GVB u adresua për evidentim tek syllabuset e lëndëve dhe ndryshimet në përmbajtjen e tyre në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>GVJ konstaton se edhe në syllabuset e lëndëve të vëna në dispozicion praktikatat e ndryshimit për vitet e depozitimit të dokumentacionit janë të pjesshme si në përmbajtje, ashtu edhe në propozim literature.</p> <p>GVJ konstaton se edhe pse është një objektiv Strategjik i shprehur në strategjinë zhvillimit të departamentit dhe Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit ndryshimi dhe përditësimi i Kurrikulës për periudhën në akreditim nuk evidentohet.</p>
Konkluzione	<p><i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe praktikave të evidentuara gjatë vizitave në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale si njësi përgjegjëse bazë për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, përmbush kryesisht standartin mbi elementët e programit të studimit, të cilët transmetojnë informacion mbi përmbajtjen, organizimin, kriteret e pranimit dhe strukturën tek aktorët që ndërveprojnë në këtë program studimi.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që DPPS duhet të konsiderojë përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme sipas objektivave strategjike të zhvillimit të departamentit dhe programit të studimit. Lëndët kanë ndarjes të madhe në orë dhe kredite, ndaj rekomandohet një shpërndarje sipas udhëzimeve në fuqi. Gjithashtu, Departamenti sugjerohet të rishikojë shpërndarjen e praktikave profesionale në planin mësimor pasi nuk</i></p>



	<i>pasqyrohet fare si lëndë, por emërtohet Praktikum dhe zhvillohet si orë seminari në semestrin e parë dhe të dytë. Shpërndarja aktuale bie ndesh me Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" pika II.12 e) sipas të cilit një ditë pune në praktikë është 5 orëshe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi mësimor i Bachelor në "Psikologji" është një program i kompletuar dhe i përgjithshëm që synon t'i japë studentëve të gjitha njohuritë e nevojshme për të zhvilluar e synuar zhvillimin e tyre të specializuar. Lëndët janë të përcaktuara dhe të shpërndara në mënyrë që të mundësojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve. GVJ pas njohjes me planin mësimor të programit të studimit, programet lëndore sipas tipeve të veprimtarive konstaton se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për tu specializuar më tej si një ekspert në fushën e psikologjisë. Këto aftësi do të bëjnë të mundur orientimin e studentëve drejt tregut të punës si psikologë, por do të mundësojnë edhe orientimin e tyre drejt studimeve të thelluara të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor dhe Master Profesional.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Psikologji" është i organizuar në tre vite me 60 kredite secili vit, në lënde dhe module lëndore, praktikum e cila sipas vizitës në institucion u dëshmuua që zhvillohet jashtë në institucione dhe nga prova finale si detyrim përmbyllës i ciklit të studimeve. Në mbërritje të objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të të mësuarit dhe kërkimit shkencor në fushë dija është ndërtuar në koherencë logjike duke filluar me lëndë të fromimit të përgjithshëm dhe në mënyrë të gradualshme, duke ndërtuar dijen semestër pas semestri në lëndët e formimit të specializuar dhe duke identifikuar në lëndët e karakterit ndërdisiplinar rëndësinë e ndërveprimit ndëpërmjet njohjes së dijeve të disiplinave të tjera sociale dhe të edukimit. (Evidencë 1.1 dhe Evidencë 1.3) Ajo që vihet re është ngarkesa e madhe në orë dhe kredite për disa lëndë/module, e cila duhet riorganizuar pas procesit të akreditimit.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Në strukturën e programit të studimit lëndët organizohen sipas tipeve të veprimtarive formuese dhe orët mësimore të tyre ndahen në orë teorike të organizuara kryesisht në lëksione 1099 orë dhe 800 orë seminare. Zakonisht më shumë se gjysma e orëve mësimore të një

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>lënde i dedikohet punës së pavarur të studentit sipas përcaktimeve të VKM 41, përkatësisht 2601 orë studimi individual. GVJ vlerëson se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>(Evidenca 2.8 dhe Evidenca 1.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” është i organizuar në lëndë dhe module sipas veprimtarive formuese, në orë teorike dhe praktike që mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe në të cilin lëndët janë të vlerësuara sipas "Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve" (ECTS) duke mundësuar transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve.</p> <p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe vizita në institucion rezulton se në programin e studimit nuk ka patur transferime studimesh për periudhën 2020-2023 dhe por disa student për mobilitet. Gjatë vizitës në institucion, studentët identifikuan mungesën e informacionit lidhur me mobilitetin si dhe kushte të tyre objektive personale që i pengonin të bëheshin pjesë e programeve të mobilitetit.</p> <p><i>(Evidencë 2.10)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale parashikohet se përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve është përgjegjës për përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të programit të studimit, duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të pesë viteve të fundit”. Sikurse u argumentua në standartin II.3, kriteri 5, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve në përmbajtjen e tyre synojnë marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, por nga syllabuset e vëna në dispozicion praktikat e ndryshimit për vitet e depozitimit të dokumentacionit janë të pjesshme si në përmbajtje, ashtu edhe në propozim literaturën bazë dhe ndihmëse.</p> <p><i>(Evidenca 2.2.1 dhe Evidenca 2.2.2)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në analizë të gjithë dosjes së programit të studimit, GVJ konkludon se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p><i>(Evidencë 1.1)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bachelor në “Psikologji” është një program studimi, i cili ofron udhëkryqet e disa disiplinave njëherazi me një gamë të përgjithshme dhe karakterizuese, integruese duke i lidhur të gjitha këto me shumë disiplina të tjera apo edhe disiplina që formojnë aftësim.</p> <p>Vetë kurrikula e programit është e tillë që të përmbushë të gjitha pikëprerjet e nevojave akademike për studentët që të vijojnë me studimet e thelluara më vonë pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Ky program studimi jo vetëm që është gjithëpërfshirës, por i pajis studentët me njohuritë më të mira të përgjithshme të një profesionisti të përgjithshëm duke i siguruar një emërues të fortë dhe bazik, i cili ka nevojë vetëm të specifikohet në profilizimet e mëvonshme të studimeve të ciklit të dytë Master.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se përgjithësisht struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e</i></p>

	<p><i>kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të mësuarit dhe "paketës" së kompetencave që e bëjnë programin e studimit të jetë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron të rishikohet me prioritet përditësimi në mënyrë të vazhdueshme i syllabuseve të lëndëve dhe moduleve lëndore me synim përshtatjen e përmbajtjes së tyre në funksion të kërkesave të reja të kompetencave për të maksimizuar ofertën me kërkesën e tregut të punës, si dhe duke përditësuar aty ku është e mundur duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse me literaturë të viteve të fundit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstaton se në praktikën e Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale hapësirat më të rëndësishme dedikuar analizës SWOT të programeve të studimit janë analizat vjetore të punës dhe raportet e vetëvlerësimit për programet e studimit.</p> <p>Gjithashtu, gjatë takimeve në institucion GVJ evidenton se Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale mban takime periodike me aktorë të ndryshëm të përfshirë në realizimin e programit të studimit si: personeli akademik me kohë të pjesshme, rrjeti ALUMNI, institucionet partnere të praktikave dhe aktorë të tjerë të tregut të punës.</p> <p>Edhe pse të diplomuarit nga programi i studimit Bachelor në "Psikologji" nuk mundet të punojnë në tregun e punës për shkak të ligjit të Ushtrimit të profesionit të Psikologut sipas Urdhërit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, programi i studimit Bachelor në "Psikologji" duke qenë se i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në programin e ofruar Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit.</p> <p>Për realizimin optimal të misionit të tij si në aspektin e përmbushjes së aspekteve kurrikulare edhe të angazhimit me profil shoqëror, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale zhvillon dhe <i>duhet të përmirësojë edhe më tej marrëveshjet e bashkëpunimit dhe të zhvillimit të partneriteteve</i> në funksion të programit të studimeve të ciklit të parë. Këto marrëveshje duhet të orientohen si në përfshirjen e sa më shumë aktorëve të brendshëm kombëtarë edhe të aktorëve të tjerë të rëndësishëm në kontekstin ndërkombëtar.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ në takimin me studentët konstatoi që këta të fundit nuk kishin shumë informacion lidhur me Zyrën e</p>

	<p>Këshillimit të Karrierës në nivel universiteti dhe nuk kishin marrë ndonjëherë pjesë në takimet e zhvilluara prej tyre. Gjithashtu nuk dinin raste të shkëmbimit të studentëve për këtë program studimi, në aktivitetet e organizuara në kuadër të Erasmus+.</p> <p>Nga studimet që realizohen në nivel universiteti, merret pak informacion lidhur me programin e studimit Bachelor në "Psikologji".</p> <p><i>(Evidenca 2.12)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me studentë të programit të studimit bachelor në psikologji gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët mbajnë kontakte të rregullta me Departamentin e Psikologjisë dhe Punës Sociale dhe kanë hapësirat e tyre të shprehjes së mendimeve rreth kurrikulës së programit të studimit, programeve lëndore dhe formave të vlerësimit. Departamenti nxit përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve për t'u angazhuar në dhënien e sugjerimeve që do të përmirësonin ofertën akademike të programit të studimit. Provë e përfshirjes së të diplomuarve është edhe lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, e cila në një peshë specifike të rëndësishme përfshin ish-studentë të Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion, CV e personelit akademik)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" është një program i ciklit të parë të studimeve në fushën e Psikologjisë. Profesionin e psikologut është në listën e profesioneve të rregulluara dhe rregullohet nëpërmjet Urdhrit të Psikologut.</p> <p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin ekzistues lidhur me ndryshimet në plan program, evidenton që prej vitesh këto ndryshime kanë qenë shumë minimale, një pjesë e tyre në emërtim apo ngarkesë orësh në auditor, duke larguar kështu vëmendjen nga kërkesat e tregut të punës. (Evidencë 2.7).</p> <p><i>Sugjerohet që kërkesat që vijnë nga zhvillimet e fundit në fushë, tregu i punës, Urdhëri Psikologut apo bashkëpunimet me institucione ndërkombëtare të referohen dhe konsiderohen me kujdes në punën e DPPS, duke u reflektuar në përmirësim të planprogramit. Disa lëndë kanë ngarkesë të madhe orësh dhe kreditesh. GVJ rekomandon një riorganizim të planit mësimor duke ulur ngarkesat që ka secila lëndë, në përputhje edhe me udhëzimet e fudnit. Kjo gjë ndihmon në harmonizimin e ofertës së programeve të studimit me kërkesat e tregut.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dhe USH nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, në diskutime me studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit dhe programeve lëndore, dhe i reflekton ato kur janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>GVJ sugjeron të mbahet në konsideratë riorganizimi praktikës dhe ngarkesave në orë e kredite që kanë disa lëndë, duke ju përmbajtur udhëzimit. Gjithashtu bazuar edhe nga përgjigjet e studentëve, praktika duhet të jetë më aktive në terren, sipas interesit që ata kanë.</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në rregulloren e studimeve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (2019), plani mësimor i programit të studimit hartohet nga departamenti dhe miratohet nga Senati Akademik, gjithashtu, programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës dhe paraqiten për miratim në fillim të çdo viti akademik në Departament dhe një kopje e tij depozitohet në formë elektronike dhe shkresore në Drejtorinë e kurrikulave dhe standarteve. Plani mësimor i programit të studimit përmban peshën specifike të orëve të leksioneve, seminarëve, laboratorëve, praktikave institucionale dhe orëve individuale për çdo lëndë të programit të studimit. Nga ana tjetër, programi i lëndës përmban objektivat, konceptet themelore të lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, detyrimet e studentit për punime individuale si ese ose detyra kursi, detajimin e përmbajtjes së lëndës sipas orëve në dispozicion për cilindo komponent mësimor si leksione, seminare, praktika e laboratore. Të gjithë komponentët e planit mësimor të programit të studimit dhe të programeve lëndore janë të miratuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. (Evidenca II, Evidenca 1.3, Evidenca 2.2)
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi programet e lëndëve GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit planifikon dhe përdor një larmi formash mësimdhënieje për të trajtuar materialin mësimor në mënyrë të larmishme, duke e diferencuar edhe sipas nevojave të studentëve. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentë të programit të studimit, GVJ evidentoi zbatimin praktik të mënyrave të shumta të mësimdhënies si tryeza të rumbullakëta, punë në grup, debate mbi tema të caktuara, ese, projekte minikërkimore, etj. Teknika mësimdhënieje që favorizojnë të mësuarin efektiv dhe që është një tregues pozitiv për respektimin e larmisë së nevojave të studentëve. (Evidenca 1.11, Evidenca 3.1)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Psikologji” ka një karrierë akademike të

<p>e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>konsoliduar dhe është i kualifikuar në Institucione brenda dhe jashtë vendit. GVJ konstaton se pavarësisht formimit profesional të personelit akademik të programit të studimit, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka praktika të mira në mbështetje të përmirësimit të kompetencave didaktike të personelit akademik në funksion të përmirësimit të cilësisë së të mësuarit. Ndër të tilla praktika mund të përmendim tryezat e rrumbullakëta, workshopet, leksionet e hapura, mbajtjen e konferencave shkencore, trajnimeve nëpërmjet programeve të shkëmbimit ERSAMUS+ dhe projekti T@sk. (Evidenca 2.9, Evidenca 3.4, Evidenca 3.5.1 CV e personelit akademik)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit Bachelor në Psikologji kanë kualifikime dhe kontribute univeristare, artikuj të botuar në revista shkencore vendase e të huaja, pjesëmarrje në konferenca e kongrese shkencore, sipas fushave të ekspertizës së angazhimeve të tyre në procesin mësimor. Nga struktura e programeve lëndore, përmbajtja e tyre dhe nga dëshmitë e studentëve gjatë takimeve në institucion GVJ mund të konkludojë se personeli akademik i programit të studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve psikologjike, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Metodatat e mësimdhënies karakterizohen nga ndërveprimi me në qendër studentin nëpërmjet metodave të ndryshme si: case study, role play, debat, brain storming, etj. Gjatë mësimdhënies rezultojnë që edhe teknologjia luan një rol të rëndësishëm, duke mundësuar prezantimin e materialeve mësimore audio-vizive, të cilat sigurojnë një mjedis të qëndrueshëm të nxëni të orientuar me në qendër studentin dhe të udhëhequr e mbështetur nga pedagogu në mënyrë që studentët të krijojnë argumenta dhe analiza të qëndrueshme teorike, duke respektuar mendimin e lirë dhe duke konsoliduar respektin ndaj njëri-tjetrit. (Evidenca 3.5, Evidenca 3.4, Evidenca 3.5.1. CV e personelit akademik)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dëshmon se në komponentët e vlerësimit të punës së departamentit mësimdhënien dhe cilësia e saj është një nga shtyllat bazë. Ky komponent është një nga elementët e diskutimit në raportet vjetore të punës së departamentit dhe të programit të studimit. Në praktikën e punës Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dëshmon sesi njësia përgjegjëse e programit të studimit ka ndërmarrë iniciativë për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe duke reflektuar sugjerimet e tyre në procesin e punës. Edhe pse nuk ka një politikë të qartë institucionale dhe një praktikë të konsoliduar institucionale për vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale dëshmon se në praktikën e saj të punës bën</p>

	përpyqje nëpërmjet bisedave të drejpërdrejta me studentë ose edhe pyetësorëve individualë mbi personelin akademik të bëjë vlerësime të tilla.			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër bën përpyqje të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes mundësisë për të marrë pjesë në konferenca të ndryshme (ICRAE 1, ICRAE 2, ICRAE 3, HRESDE etj) dhe botime në buletin shkencor. USH është pjesë e një memorandiumi mirëkuptimi me institucione të tjera të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe bashkëpunime me programin ERASMUS +. Një angazhim i tillë dëshmon se USH në nivel institucional nxit, promovon dhe ngrë struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura janë qendra të inovacionit dhe përgjegjëse për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja dhe më pas personelin akademik të USH e shndërrojnë në personel trajnues për palë të tjera. (Evidenca 3.7, Evidenca XXIX, Evidenca 3.3)			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, RVB-së dhe vizitës në institucion, konstaton se Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale garantojnë krijimin e strukturave, politikave dhe mundësisë që krijojnë kushte të përshtatshme për mësimdhënie inovative dhe në respekt të diverzitetit të studentëve, si dhe nxisin procesin e të mësuarit efektiv dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit, sistemin e vlersimit të studentit, formatin e punimit të diplomës dhe provimit të formimit të përgjithshëm. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale. Edhe në syllabusin e lëndëve përcaktohet mënyra e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet që ata kanë në secilën lëndë. Aty thuhet qartë që në vlerësimin e arritjeve të studentit, pedagogu mbështetet në përfundimet e vlerësimit të vijueshëm, në frekuentimin

	<p>dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, detyra kursi. Të gjitha jepen qartë në rregulloren e programit të studimit neni 13, 14, 15, 16 dhe 17 si dhe në rregulloren e universitetit.</p> <p><i>(Evidenca 1.3, Evidenca II)</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit Bachelor në "Psikologji" në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e diplomimit, si dhe në syllabuset e lëndëve jepet një informacion i qartë mbi procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët.</p> <p>Nga materiali i prezantuar në RVB dhe nga takimet me studentë rezultoi se në javën e parë të çdo semestri studentëve ju prezantohen nga pedagogët e lëndës syllabuset e lëndëve/ moduleve duke konsideruar në mënyrë të kujdesshme kompetencat e lëndës, objektivat dhe qëllimet lëndore, rezultatet e të mësuarit, metodat e mësimdhënies, metodologjinë dhe komponentët e vlerësimit të studentit dhe dijeve të tij profesionale në përfundim të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe e rekomanduar për studim.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në proces nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe komponentëve të tij dhe vlerësimit përfundimtar. Mënyrat e vlerësimit të studentit synojnë t'i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, për këtë arsye përdoren si metoda vlerësimi detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, projektet, analizimi i rasteve, esetë, dorëzim dosje, praktika, etj. Kontrolli i njohurive përcaktohet sipas rregullores së studimeve në FSHE edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Psikologji". Mënyra e vlerësimit të një lënde mund të jetë me shkrim, me zë ose i kombinuar që përmban 60-80% të vlerësimit final si dhe vlerësimi vazhduar me 20-40%.</p> <p><i>(Evidencë 1.3, Evidencë 2.2 dhe Evidencë II)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të studimit - në psikologji. Duke iu referuar sylabuseve, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme krijon kushte për një të nxënë efektiv dhe që bazohen në zhvillimin e kompetencave profesionale të përgjithshme për figurën e psikologut. Ndërkohë departamenti çdo vit organizon mbledhje me tematikë analizën e punës, ku reflekton të gjitha risitë. Studentët janë një pjesë thelbësore e punës së departamentit dhe të lidhur ngushtë me stafin akademik. Përfshirja e studentit në vlersimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët, ka nisur të realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie. Gjithashtu edhe diskutimet e stafit akademik me studentët në përfundim të lëndës apo modulit, për të marrë një reagim mbi rezultatet e pritshme, janë një tjetër formë që përdoret në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të programit të lëndës.</p>

	<i>(Evidenca 1.11)</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ konstatoi se marrëdhëniet pedagogë – studentë, karakterizohen nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi që lehtësohet nga numri jo shumë i lartë i studentëve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies dhe në ndërtimin e marrëdhënies të punës dhe të respektit të ndërsjellë mes tyre. Duke u mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog – student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studenti. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Fakulteti i Shkencave të Edukimit në rregulloren e studimeve dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në rregulloren e programit të studimit për Bachelor në “Psikologji” kanë hartuar dhe zbatojnë procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas Rregullores së studimeve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/ modulit dhe vlerësimi në provën përfundimtare provim/ testim. Elementët, pesha specifike në përqindje të notës përfundimtare, dhe format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe testimit përfundimtar shprehen në mënyre eksplicite në programet e lëndëve. Vlerësimi përfundimtar i shprehur në notë i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë semestrit, bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit si pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm. Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit, sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e punimit të diplomës dhe provimit të formimit të përgjithshëm. <i>(Evidenca 2.2, Evidenca 1.3, Evidenca II)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka bashkëpunim me Albanian-American Development Foundation (AADF) për zbatimin e projektit Clean Score mbi cilësinë e materialeve mësimore dhe

<p>të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>vlerësimin e performancës së studentëve. Nga ky bashkëpunim është zhvilluar dhe përdoret platforma elektronike e Clean Score të ngritur nga AADF për testime dhe vlerësim të informatizuara të njohurive, të cilat rrisin transparencën dhe objektivitetin në vlerësim. Gjithashtu, gjatë periudhës së pandemisë është përdorur platforma Microsoft Teams e cila vazhdon ende për detyra dhe mbledhje materiale me studentët).</p> <p><i>(Evidenca 3.10, Evidenca XXI)</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas Rregullores së studimeve në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe rregullores së programit të studimit, vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj dhe kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet e parashkuara në rregulloren e studimeve dhe në programin e lëndës. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet sipas sitemit të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë). Këto elemente gjithashtu janë të pasqyruar edhe në syllabuset e çdo lënde.</p> <p><i>(Evidenca II, Evidenca 2.2)</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se në të gjitha format e vlerësimit të njohurive të fituara, vlerësimi i studentit shoqërohet me komente mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta në dijet e mësuara dhe aftësitë e përvetësuara në mënyrë që të ndërtohen strategji të suksesshme për të rirorientuar të mësuarin efektiv për të arritur rezultate më të larta në vijim. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe provimet e ndërmjetme u evidentuan nga takimet me student dhe personelin akademik si element të rëndësishëm të procesit të “korrigjimit” të mangësive nëpërmjet shkëmbimit të komenteve të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e rezultateve të studentit në provën finale dhe në të ardhmen.</p> <p><i>(Evidenca 3.12, Informacion nga vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në nenin 8 të Kodit të Etikës parashikohen parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore ndër të cilat edhe ndalesat ndaj plagjiaturës dhe kopjimit në detyra e provime. Kriteret dhe kërkesat mbi sjelljet etike janë të parashtruara edhe në programet e lëndëve të programit të studimeve sipas VKM 41 të ndryshuar në seksionin “kodi i etikës”. Gjithashtu edhe në Rregulloren e USH nenei 33 parashtrohet qartë kjo gjë.</p> <p><i>(Evidenca 3.13, Evidenca II)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Transparenca me studentët në lidhje me komponentët e vlerësimit dhe peshën specifike të secilit komponent në vlerësim e bën rezultatin e kontrollit të dijeve dhe të aftësive profesionale të bazuar në meritë dhe në skema racionale që minimizojnë ndikimet subjektive. Korrigjimet e automatizuara të provimeve rritin objektivitetin në vlerësim gjithashtu. Të gjitha procedurat shpjegohen qartë në Rregulloren e Universitetit, neni 30, pika 4,5 dhe 6. Procesverbali, i plotësuar me rezultatin e provimit, dorëzohet në sekretarinë mësimore i nënshkruar nga komisioni përkatës. Gjatë takimit me student, rezultoi se afatet e informimit të vlerësimit respektohen me korrektësi nga personeli akademik programit të studimit Bachelor në “Psikologji”.</p>

	<i>(Evidenca 1.3 dhe Evidenca II)</i>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Rregullorja e studimeve në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër parashikon të drejtën për ankimim të rezultatit dhe procedurës së vlerësimit dhe realizimit të provimit nga ana e studentit, duke garantuar të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Procedura e parashkruar në rregullore garanton transparencë për palët e përfshira në proces rivlerësimi dhe dokumentohet e arkivohet sipas parashikimeve në nenin 30.</p> <p>Nga GVB-ja, personeli akademik i programit të studimit dhe studentët u evidentua se nuk ka patur student, të cilët kanë ndjekur procedurën e ankimit sipas rregullores së studimeve të USH-së. Në praktikën e komunikimit të vlerësimit në programin e studimit evidentohen ura të mira komunikimi që ju mundësojnë studentëve të jene ballë për ballë me pedagogun e lëndës në momentin e komunikimit të vlerësimit dhe të konsultimit të menjëhershëm të çdo pakënaqësie të mundshme mbi vlerësimin.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të rregullores së posaçme të studimeve në USH siguron një mjedis ndërveprimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve që mundëson dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një kurrikule të pasur si në aspektin teorik edhe në atë praktik. Në analizë të planit mësimor të programit të studimit, programeve të lëndëve/ moduleve rezulton se programi garanton thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Programi i studimit ofron një kurrikul, e cila në mënyrë të përshkallëzuar dhe të strukturuar integron dijet e formimit metodologjik shkencor si dhe të lidhur ngushtë me profesionin e psikologut duke dhënë një panoramë të përgjithshme në këtë fushë. Për thellimin e dijeve në praktikën profesionale, studentëve ju ofrohet një lëndë me emrin Praktikum. Nga biseda me studentët, ata ndiqeshin në terren nga supervizori praktikës, por ndërkohë kjo lëndë në kurrikul nuk jepet qartë nëse është praktikë në terren apo praktikum në klasë. Kjo duhet të specifikohet më qartë nga departamenti për të dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë praktikë aktive në institucione. Aftësitë shkencore dhe dijet në fushën e kërkimit studentët i testojnë në</p>

	<p>mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të lëndëve nëpërmjet projekteve të kursit dhe detyrave kërkimore. (Evidenca 1.1 dhe Evidenca 2.2)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” nëpërmjet strukturës së tij formative dhe përmbajtësore përpos synimit për të formuar profesionistë të specializuar në fushën e psikologjisë, garanton edhe zhvillimin e dimensioneve të tjera humane, sociale e komunikative të studentëve që ndjekin programin e studimit. Teknologjia e informacionit rezulton të jetë një aset në ndihmesë të informacioneve ndihmëse në funksion të programit të studimit, por edhe në funksion të zhvillimit të aftësive të komunikimit digjital. Në programet lëndore fondi i literaturës së detyrueshme dhe më shpesh literaturës së rekomanduar është në gjuhë shqipe por edhe në gjuhë të huaj, kryesisht gjuhën angleze, duke krijuar kështu një mundësi të shtuar për studentët e programit të studimit për të zhvilluar aftësitë e tyre edhe gjuhë të huaj në përputhje me fushën e studimeve. (Evidenca 1.1 dhe Evidenca 2.1)</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në ‘Psikologji’ i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë të profileve interdisiplinare në kontekstin e fushës së psikologjisë. Kjo larmishmëri mund të shihet e plotë duke qenë se lëndët mësimore bazohen në një literaturë cilësore që ndihmon studentët të marrin njohuri të thelluara për një sër profilesh profesionale. Pasurimi i planit mësimorë me lëndë e module të profileve të ndryshme të psikologjisë ndihmon studentët të qartësojnë idetë e tyre në lidhje me drejtimit e dëshiruar profesional edhe në ciklin tjetër të studimit. Në orën e fundit të mësimit personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe jep udhëzimet përkatëse për detyrimet përmbyllëse të lëndës/modulit. Një fakt i tillë u evidentua edhe gjatë bisedave me studentë të programit të studimit. (Informacion nga vizita në institucion dhe programet e lëndëve)</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë dhe zhvillimin e shprehish duke prekur aspektet praktike në një sër lëndësh e modulesh. Kjo gjë realizohet duke përdorur role -play, diskutimin e rasteve klinike etj. Disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë, përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve. Gjithsesi me ndikim pozitiv në këtë aspekt është literatura e përdorur, e cila përditësohet vazhdimisht nga stafi akademik, aktivitetet e ndryshme ekstrakurrikulare të cilat janë të shumta dhe të larmishme dhe prekin një sër fushash e profilesh. (Evidenca 3.2, Evidenca 3.17)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Psikologji” është vazhdimisht i interesuar për të qënë pjesë e diskutimeve shkencore mes profesionistëve të fushës duke marrë pjesë në</p>

zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>aktivitete shkencore si brenda edhe jashtë vendit, duke u informuar mbi zhvillimet e reja në fushën e tyre të ekspertizës dhe në fushën e studimeve psikologjike.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit dëshmon të jetë një urë lidhëse ndërmjet informacioneve më të fundit të shkencës dhe teknologjisë dhe studentëve të programit të studimit. Personeli akademik i integron këto dije në strukturën e programeve lëndore dhe temave mësimore ose i shpërndan këto njohuri nëpërmjet orëve të hapura të zhvilluara edhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke qënë të angazhuar vetë si lektorë ose edhe duke ftuar kolegë vendas e të huaj ekspertë në fusha të ndryshme që lidhen me programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 3.1)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve të standartit III.4 konkludon se programi i studimit Bachelor në "Psikologji" garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke realizuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>Njësia bazë mbështetet në rregulloren e posaçme të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës për të organizuar në mënyrë korrekte këtë proces. Kjo rregullore u vihet në dispozicion studentëve nga ana e njësisë bazë në takimet e realizuara me studentët dhe nga përgjegjësi i departamentit. Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit Bachelor në "Psikologji" dhe mbi manualin e punimit të temës së diplomës, institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët mbrojnë diplomën. Kriteret për mbrojtje diplome me temë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes përgjegjësit të departamentit.</p> <p><i>(Evidenca 3.18, Evidenca II)</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblylëse.	<p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në Fakultetin e Shkencave të Edukimit si struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit siguron që personeli akademik të asistojë në mënyrë të vazhdueshme diplomantët duke ju vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblylëse.</p> <p><i>(Evidenca 3.18, Evidenca 3.19)</i></p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	<p>Mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e provimit final komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterit ku për secilën kategori mund të ofrohen një numër i ndryshëm pyetjesh. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke</p>

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. (Evidenca 3.19, Evidenca 1.1)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Stafi akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndën e tyre. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e seancave metodologjike përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit. Secili pedagog cakton grafikun e takimeve me studentët që ka në udhëheqje. (Evidenca 3.20 dhe Evidenca 3.18)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së Studimeve të Universitetit dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit si dhe Manualit të punimit të diplomës rezultojnë se Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka gjithë suportin e Fakultetit dhe Institucionit për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në Rregulloren e studimeve në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër përcaktohen procedurat e mbrojtjes së diplomës që nga ngritja e komisionit të vlerësimit, miratimi i komisionit të vlerësimit, caktimi i oponentit të temës së diplomës, dokumentacioni final i dorëzuar për mbrojtjen e temës së diplomës dhe vlerësim para një komisionit të përbërë nga jo më pak se 3 veta. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Përbërja e komisionit të vlerësimit dhe kryetari i tij caktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i përcillet Dekanit të Fakultetit për miratim. Komisioni në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat regjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohen studentëve. Nota përfundimtare si rregull përcaktohet me pëlqimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit. (Evidenca 1.3, Evidenca 3.18)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” është konform ligjeve dhe procedurave të QSHA-së për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave. Forma e paraqitjes së diplomës është konform profilit dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listë notash dhe suplementin e diplomës; në programin e studimit Bachelor në “Psikologji”. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin e tij. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave kërkimore e profesionale të</p>

	studentit dhe pajisjen me diplomë referuar nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. (Evidenca 3.21 dhe Evidenca 3.22)								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Universiteti i Shkodrës ka një rregullore të posaçme për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve në universitet. Kjo rregullore garanton që gjithë aktorët e përfshirë në jetën universitare të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër të trajtojnë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin e studentit dhe të konsiderojë politikatat e mbrojtjes së të dhënave në administrimin e informacionit. (Evidenca II dhe Evidenca I.3)								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Fakulteti i Shkencave të Edukimi, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, kanë hartuar rregullore të cilat përcaktojnë qartë procedurën e detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit bachelor dhe në përmbyllje të studimeve e pajisin studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përmbushur plotësisht standartin III.5.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik, konfirmojmë se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Psikologji” i përshtaten kërkesave të këtij programi studimi. Janë angazhuar lektore dhe asistente lektore me tituj dhe grada shkencore sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në Rregullore Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Republikën e Shqipërisë” për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p>Aktualisht Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka 7 personel akademik me kohë të plotë (PAE) nga të cilët: (1) Prof. Asoc. Dr., (6) Dr., dhe 6 personel akademik me kohë të pjeshme pra me kontratë (PAK) nga të cilët (1) Dr. (5) MSc.</p> <p><i>(Evidenca 1.7 dhe Evidenca 3.5)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të dhënat që ka paraqitur Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale për planifikimin e ngarkesës për çdo vit akademik dhe për realizimin e ngarkesës mësimore tregojnë qartë respektimin e kornizës ligjore në fuqi.</p> <p><i>(Evidenca 4.13 dhe Evidenca 4.1)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me stafin e burimeve njerzore, departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata pa afat dhe është i punësuar pranë IAL prej shumë vitesh, si dhe i angazhuar në këtë program që prej ditës së parë që programi është hapur, e cila u konfirmua edhe nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënien në këtë program. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë të reflektuara në Statutin e Universitetit dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Institucioni nëpërmjet DBNJ ndjek në mënyrë rigoroz procedurat në bashkëpunim me Departamentin.</p> <p>Kontrata e punësimit si detyrim ligjor zbatohet në të gjitha punësimet e kryera. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” ka angazhuar staf akademik bazuar në parimet e barazisë, në të drejta, detyrime e përgjegjësi për të garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor ku ajo çfarë vihet re është mungesa e përfshirjes së personelit administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 4.12 dhe Evidenca 4.17)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>I gjithë procesi i rekrutimit dhe vlerësimit është konform kritereve të shpallura, ndiqet dhe vlerësohet nga drejtoria e specializuar për këtë proces Drejtoria e Burimeve Njerzore, e cila e fillon procesin pasi merr kërkesën nga njësia bazë. Në Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e Përgjithshme përcaktohen qartë të gjitha procedurat e për rekrutimin e stafit akademik për realizimin e programit të studimit. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi është bërë sipas nevojave të Departamentit, i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike për vendet e punës.</p>

	<p>GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p><i>(Evidenca 4.2, Evidenca XI dhe Evidenca II)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” nuk parashikon realizimin e orëve laboratorike.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Në RVB janë paraqitur të dhënat për personelin e angazhuar për realizimin e këtij programi studimi. Këto të dhëna paraqesin anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik. Burimet njerëzore administrojnë dokumentacionin përkatës për stafin e angazhuar në këtë program studimi CV-të në format specifik dhe dokumentacionin përkatës. (Referuar RVB dhe vizites në burimet njerëzore).</p> <p><i>(Evidenca 1.7, Evidenca 1.8 dhe Evidenca 1.11)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Të dhënat e paraqitura në RVB për këtë program studimi tregojnë se Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”. Kapacitetet e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike në përmbushje të praktikës profesionale dhe në funksion të punimit të temës së diplomës. Në kuadër të procesit të kryerjes së praktikës profesionale, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale janë angazhuar maksimalisht në realizimin e marrëveshjeve me organizata të ndryshme në nivel vendor apo qendror.</p> <p><i>(Evidenca 1.10, Evidenca 1.14, Evidenca 1.5).</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale në nenin 6 të saj parashikohet përgjegjësi i departamentit si autoritet drejtues akademik për këtë program studimi. Ai është përgjegjës për të gjithë mbarëvajtjen e ecurisë dhe zhvillimit të planin mësimor, kërkimi shkencor, praktikat profesionale e më gjerë. Referuar ngarkesës që ka përgjegjësi departamentit, GVJ rekomandon që në cilësinë e koordinatorit të programit të studimit të caktohet një anëtar i personelit akademik efektiv, i cili do jetë përgjegjës për ecurinë e programit dhe do jetë në kontakt të vazhdueshëm me përgjegjësin e departamentit lidhur me praktikën profesionale.</p>


	<i>(Evidenca 1.6, Evidenca 1.13, Evidenca 1.12).</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore e përgjithshme dhe specifike e profesorëve, lektorëve, dhe asistent lektorëve të angazhuar në këtë program studimi është në përputhje me kërkesat e këtij programi sipas natyrës dhe moduleve që ai ka. Vihet re mungesa e përfshirjes së personelit administrativ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, ka mjediset mësimore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse, për të zhvilluar mësimin në të njëjtin orar. Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse gjithashtu edhe numrit të studentëve. <i>(Evidenca 4.13)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton se FSHE ka mbulim jo te plotë te auditorëve me infrastrukturë apo mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e procesit mësimor. Në vazhdimësi, pajisja e sallave me projektorë dhe paisje të tjera të teknologjisë së informacionit duhet ti përshtatet ndryshimeve dhe zhvillimit teknologjik të shpejtë që bën të dobishëm përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. <i>(Evidenca 4.13)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” nuk parashikon realizimin e orëve laboratorike.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të	Natyra e këtij programi studimi nuk kërkon laboratorë të teknologjisë së informacionit për realizimin e objektivave të tij.

teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>(Evidenca. 4.15).</i>			
Konkluzione	<i>Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën shqipe (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Studentët kanë akses në literaturën bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe. Kjo mundësohet nga tekste mësimorë të përkthyer nga Shtëpitë Botuese, tekste mësimorë të shkruar nga stafi pedagogjik. <i>(Evidenca 2.2)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga RVB dhe takimet në Departament evidentohet fakti që Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale diskuton dhe miraton programet mësimore të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit lidhur me përditësimin e literaturës dhe ndjek botimet e reja nga të gjitha burimet që disponon, sidomos ato që lidhen drejtpërdrejtë me kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Psikologji me synimin për t'i përditësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Nëpërmjet projektit T@sk/Erasmus+, biblioteka e universitetit është e pasur por ka akoma nevojë që të disponojë literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve. <i>(Evidenca 4.14)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë përfshirë është pa pagesë për të gjithë. (Referuar RVB dhe vizitës në institucion) biblioteka e Universitetit “Luigi Gurakuqi” Shkodër është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. <i>(Evidenca 4.4 dhe Evidenca 4.5).</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore	Biblioteka e Universitetit të Shkodrës “Luigi Gurakuqi” lidhur me programin e Psikologjisë nuk disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Botimet e reja mungojnë, kjo e konfirmuar edhe gjatë vizitës në institucion lidhur kjo me mungesën e fondeve. Studentët nxiten të përdorin bibliotekën online Ulibrary e cila është e pajisur me literaturë bashkëkohore ndërkohë që nëpërmjet projektit

sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	T@sk/Erasmus+, biblioteka e universitetit është pasuruar me libra të rinj, botime të viteve të fundit në fushën e psikologjisë, punës sociale, sociologjisë dhe kërkimit shkencor (Evidenca 4.3, Evidenca XXVI, Evidenca 4.14).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. Aksesit në bibliotekën online Ulibrary, është pa pagesë për studentët dhe stafin akademik. Aksesit në këtë librari online u mundësua nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si pjesë e realizimit të kërkesave të studentëve për një arsim më cilësor (Evidenca 4.3, Evidenca XXVI, Evidenca 4.5).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Gjithashtu, në dispozicion të studentëve është edhe një personel i IT i cili i ndihmon dhe i orienton në kërkesat që ata shfaqin (Evidenca 4.10)			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Ajo është e hapur nga e Hëna në të Premte, ora 8:00-19:00 dhe të Shtunë nga 8:00-13:00. (Evidenca 4.4).			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Çdo vit, sipas kërkesave të stafit akademik përgatitet lista e blerjeve për të pasuruar fondin e Bibliotekës. Kërkesat evidentohen në Departament të cilët në fillim të vitit akademik diskutojnë programet e lëndëve, ndryshimet, përmirësimet dhe përcaktojnë kërkesën për literaturën. Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese por botimet e reja mungojnë, kjo e konfirmuar edhe gjatë vizites në institucion lidhur kjo me mungesën e fondeve për blerje. (Evidenca 4.5)			
Konkluzione	<i>Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka krijuar kushtet për të mbështetur programin e studimit me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e tij. Biblioteka ka mjediset e përshtatshme por nuk disponon fondin e nevojshëm të titujve. Biblioteka përmban literaturën bazë por jo të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mësimnxënies për realizimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht



Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër përmban informacion personal të studentit dhe adresat e tyre elektronike. Nëpërmjet profesionistëve të IT të cilët menaxhojnë sistemin online të USH (Pitagora), njësisia bazë së bashku me sekretarinë mësimore disponojnë informacion për çdo student që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të ciklit të studimeve <i>(Evidenca 4.16 dhe Evidenca XXII)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Për realizimin e programit Bachelor në “Psikologji” sistemi i brendshëm i menaxhimit është efikas. Burimet njerëzore dhe Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale administrojnë dokumentacionin përkatës për partnerët dhe për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Aplikacioni SMAK është një software, i ndërtuar si rezultat i domosdoshmërisë për informatizimin e menaxhimit akademik. Softi është i bazuar në teknologjinë web dhe si i tillë është i aksesueshëm nga çdo kompjuter i lidhur në internet. Të dhënat janë të ruajtura në një bazë të dhënash qendrore në një server, i cili ndodhet në ambientet e AKSHI-t. Përgjegjësi i departamentit plotëson të dhënat për ngarkesat e pedagogëve dhe planet mësimore <i>(Evidenca XXIV)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Shkëmbimi i informacionit midis stafit dhe studentëve bëhet përmes e - maileve të stafit që vihen në dispozicion të studentëve nga fillimi i vitit akademik. Përmes sistemit të integruar “Pitagora” parashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit. Faqja web e Universitetit shpërndan informacion në vazhdimësi për ngjarje të rëndësishme në lidhje me zhvillimet e tij. Sistemi Pitagora nuk ka të integruar platforma të komunikimit interaktiv. Komunikimi interaktiv dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet nëpërmjet platformës office365.com Aktualisht, në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër përdoret platforma office365.com për komunikimin me email zyrtar në rang universiteti duke përfshirë këtu pedagogë, stafe jo akademike dhe studentë. Aplikacioni Microsoft Teams i kësaj platforme shërben si LMS <i>(Evidenca 4.16, Evidenca XXIII, Evidenca XXIV, Evidencë 4.7)</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Monitorimi i aktivitetit akademik e administrative bëhet nga njësisia bazë – Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale që raporton te Dekani për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik. Platformë office365.com ofron disa web apps të cilat lehtësojnë ndjeshëm punën e përditshme të studentit dhe të pedagogut. Disa

	<p>prej aplikacioneve që na ofron platforma janë: paketa e plotë office, OneDrive, oneNote, klasat virtuale, etj. Në faqen web të USH-së janë të prezantuar të gjithë udhëzuesit që mund të përdoren si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët lidhur me aplikacionet e kësaj platforme (Evidencë 4.6)</p>						
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e internetit përmban dokumenta dhe informacion për personelin akademik, programet e studimit, njoftime, aktivitete të ndryshme, të publikuara në 2 (dy) gjuhë, shqip dhe anglisht. (Evidencë 4.8)</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Monitorimi i aktivitetit akademik e administrative për mbarëvajtjen e procesit mësimor bëhet nga njësia bazë dhe ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik dhe realizimin e programit mësimor. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Buxheti financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas Cikleve dhe programeve të studimit. Planifikimi i financimit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit realizohet në mënyrë paraprake. (Evidenca 4.11 dhe Evidenca XVIII).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban të gjithë elementët financiarë në bazë programi. Plani i financimit të programit të studimit përmban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orë mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative etj., si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe çdo zë tjetër të nevojshëm. (Evidenca XVIII).</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të veprimtarisë nga njësitë e auditimit të brendshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brendshëm çdo vit. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, bazuar në raportet e auditimit dhe të dhënat financiare.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe përmban elementët financiarë për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik. Planifikimi I financimit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e institucionit realizohet në mënyrë paraprake. Në analizat financiar merren në konsideratë shpenzimet për pagat e sigurimeve, shpenzimet për shërbime, shpenzimet për investime, shpenzime operative tarifat e propozuara, paga mesatare e personelit akademik dhe atij ndihmës etj. (Evidenca 4.11)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare USH planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. (Evidenca 4.12)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Plani i financimit dhe buxheti financiar dhe auditimi hartohen në nivel institucional dhe përmbajnë të gjithë elementët financiarë në bazë programi. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------------



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri, grupi i vlerësimit të jashtëm u bazua në rregulloren e universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e këtij programi studimi përcaktohen qartë të gjitha organet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për mbarëvajtjen e plotë të këtij program studimi. procesi që nga hyrja deri në daljen e studentëve në të gjithë ciklin e studimit, mbështetet në politika dhe procedura të cilat janë në respektim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 1.3)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Statutin USH, pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>USH-ja mban kontakte me MAS dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit lidhur me informimin e nxënësve të shkollave të mesme. Pranimi i studentëve të ciklit të parë koordinohet gjithashtu me portalin e maturanit "U-Albania". Portali u mundëson të gjithë studentëve të ardhshëm të marrin informacion mbi kriteret e pranimit, kurrikulën, kuotat dhe tarifën e studimit. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve paraqiten në Rregulloren e USH, Rregulloren e FSHE, si dhe në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji".</p> <p><i>(Evidenca 5.1, Evidenca 5.3, Evidenca 5.5, Evidenca 1.3)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Sipas vendimit të Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve për studentë për ciklin e parë të studimeve, kriteret e vecanta që duhen përmbushur nga ana e kandidatëve hartohen dhe bëhen publike si nga ana e Universitetit dhe nga Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Bazuar në udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019 për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, aplikimi i maturanëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e maturës shtetërore online www.matura.qsha.gov.al për programet e ciklit të parë të studimeve. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike në faqen zyrtare në internet, çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve.</p> <p><i>(Evidenca 5.1 dhe Evidenca 5.3)</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të</p>	<p>Transparenca, aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me programin e studimit në USH bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit dhe mjeteve të komunikimit për kandidatët për student, studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë të gjithë ciklit akademik.</p> <p>Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit</p>

kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen zyrtare të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (www.unishk.edu.al). (Evidenca 5.1, Evidenca 5.3, Evidenca 2.4).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në mbështetje të programit të transparencës, kandidatët për studentë, të gjithë të interesuarit dhe publiku i gjerë udhëzohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e vecanta dhe të përgjithshme për pranimin në programin përkatës të studimit. Në periudhën Shkurt-Mars institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Fakulteti i Shkencave të Edukimit. Format më të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t’u regjistruar në programin e Bachelor në “Psikologji”, janë të shumta si ture në Gjimnaze, këshillimi në hollin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit gjatë periudhës së regjistrimeve, informacion në website, në rrjete sociale etj. Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet Panairi i punës dhe vullnetarizmit, Panairi Work and Study, Ditët e hapura etj. (Evidenca 5.5, Evidenca 5.6, Evidenca 3.20).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale çdo vit akademik përcakton, harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi veçanta që aplikojnë për program studimi, transferim studimesh, studentët me aftësi të kufizuar, komuniteti rom dhe ai ballkano egjiptian, studentet me statusin e jetimit, për shtresa në nevojë, si dhe studentë të ardhur nga trojet, për vitin akademik pasardhës. (Evidenca 5.1, Evidenca 5.3).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale përcakton, harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për përzgjedhjen e kandidatëve me shtetësi të huaj për vitin akademik pasardhës. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i percillen Senatit Akademik, i cili merr vendim. (Evidenca 5.3, Evidenca 5.1)
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër miraton bursa për kategoritë: studentë të shkëlqyer, studentë që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentë në nevojë etj. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër i ka kushtuar një rubrikë të veçantë në website Bursës së studentëve, në të cilën gjenden vendimet e Universitetit si dhe kriteret për të përfituar Bursën për 7 vitet e fundit. Gjithashtu në këtë rubrikë gjendet e afishuar edhe baza ligjore https://unishk.edu.al/universiteti/bursa
Konkluzione	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura

	<i>për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	I gjithë informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe të kalimit nga një vit në tjetrin janë të parashikuara në rregulloren e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, programit të studimit dhe rregulloren e Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale. <i>(Evidenca II, Evidenca 1.3).</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në Rregulloren e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme janë të përcaktuara dhe të kuptueshme e të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe për të gjithë të interesuarit. Fakulteti i Shkencave të Edukimit ofron informacion në lidhje me procesin e ekuivalentimit të studimeve, me universitetet e tjera jashtë vendit. <i>(Evidenca 1.3, Evidenca 2.4).</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Sipas rregullores së Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Psikologji”, informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të aftësive dhe dijeve u vihet në dispozicion studentëve ana e Departamentit si dhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve nga ana e lektorëve të lëndëve respektive që në orën e pare mësimore të semestrit. Studentët njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur bëhet dhe prezantimi i përgjithshëm i rregullës së USH dhe programit të studimit <i>(Evidenca 1.3, Evidenca 2.2, Evidenca 3.13).</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren, të gjitha etapat që lidhen me kriteret dhe procedurat e diplomimit të programit të studimit janë të përcaktuara, të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët duke vënë në dispozicion strukturat përkatëse përgjegjëse dhe kanale e mjete të ndryshme komunikimi. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, dhe të gjitha fazat që të shpien në mbrojtjen e diplomës. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura që në fillim të çdo viti akademik <i>(Evidenca 3.19).</i>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale angazhohet në fillim të çdo viti intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë për studentë duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura ku i shpalosen informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qenë të hapur ndaj feedback, diskutimeve apo sugjerimeve të mundshme.</p> <p>Veprimtari të tilla, të njohura si “Ditët e hapura”, në nivel Fakulteti, kanë për qëllim të njohin maturantët me programet e studimit që ofrohen si dhe i ftojnë në institucion. Gjatë javëve të regjistrimit Fakulteti i Shkencave të Edukimit, përmes grupeve të punës të përbërë nga staf akademik informon maturantët që janë të interesuar të studjojnë aty.</p> <p>Nga sa konstatohet Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka prioritet gjithashtu dhe promovimin e programit Bachelor në “Psikologji” online, në website si dhe në rrjetet sociale të DPPS. Gjithashtu, në fillim të vitit akademik çdo student pajiset me fletëpalosje të FSHE dhe USH</p> <p><i>(Evidenca 3.13, Evidenca 5.5, Evidenca 5.6),</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Java e Orientimit dhe Guida e Studentit është një praktikë e përhershme në USH dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në fillim të çdo viti akademik, organizon një takim informues dhe orientues me studentët ku prezantohen të gjitha elementet e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e institucionit etj.</p> <p><i>(Evidenca 5.5), (Evidenca 5.6), (Evidenca XIII), (Evidenca XIII), (Evidenca XLII).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të hapura për maturantët.</p>

	<p>Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, organizon takime informuese me studentët si dhe u prezanton studentëve Broshurat. (Evidenca 2.2), (Evidenca 4.8), (Evidenca 5.5), (Evidenca 5.6), (Evidenca XIII).</p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe konkretisht Zyra e Këshillimit dhe Karrierës si strukturë përgjegjëse e institucionit orienton dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikave mësimore, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mundësive të punësimit. (Evidenca 5.6).</p>						
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër publikon të dhënat në faqen zyrtare web për Strategjinë e Komunikimit informacioni i cili është lehtësisht i aksesueshëm dhe i plotësuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet strukturave dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit. FSHE për këtë program studimi disponon kapacitete dhe logjistikë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Ajo çfare vihet re është mobilitet jo i lartë i studentëve. (Evidenca 1.1). https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022</p>						
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, studentit i ofrohet informacioni i përditësuar nga faqja zyrtare web, përdoren edhe platforma të tjera bashkëkohore për të shpërndarë informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të detajuar lidhur me programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme e të përditësuar edhe në distancë. (Evidenca XX, Evidenca XLIX).</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm vëren se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit. Ajo çfarë vihet re është mobiliteti jo i lartë i studentëve.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër disponon statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve të cilët kanë aplikuar, numrin e studentëve të cilët vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar nga programet e studimit në Sekretarinë Mësimore të FSHE. Vihet re se ky program studimi synon mbajtjen e këtyre të dhënave për të</p>

	<p>patur të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar të diplomuar për çdo vit akademik. (Evidenca 5.11).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga kontaktet me sekretarinë u vu re se Sekretaritetë Mësimore, organizojnë punën brenda afateve të paracaktuara për të realizuar regjistrimet e studentëve fitues të programeve të ciklit të parë. USH harton statistikën vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, të largimeve para përfundimit të programit apo të mospërfundimit me sukses të programit të studimit si dhe të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> <p>Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë.</p> <p>Studentë të regjistruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Viti akademik 2022-2023: 37 studentë; <input type="checkbox"/> Viti akademik 2021-2022: 38 studentë; <input type="checkbox"/> Viti akademik 2020-2021: 31 studentë; <input type="checkbox"/> Viti akademik 2019-2020: 23 studentë; <p>(Evidenca 2.4).</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat për studentët janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat ruhen konform akteve rregullatore të Universitetit Të dhënat statistikore të studentëve përgatiten dhe ruhen elektronikisht si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare, kryesekretaret në bashkëpunim me sekretaret mësimore kryejnë pasqyrimin e notave në bazën elektronike të të dhënave konform manualit për funksionimin e sekretarisë.</p> <p>(Evidenca 1.3),</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sekretaritet mësimore hartojnë raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit aktual ofron funksionalitetin e nevojshëm për stafin akademik, administratën dhe ecurinë e studentëve për gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga regjistrimi në programin e studimit, vlerësimet e deri në diplomimin e tyre. Paketa software ESSE 3 dhe Pitagora (2022) mundëson një database të dhënash mbi studentët për cikël studimi.</p> <p>(Evidenca XXII)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në</p>	<p>Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale për çdo vit akademik harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p> <p>Ai disponon përmes sekretarisë mësimore dhe IT-së të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe janë duke u bërë</p>

drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	përpjekje të bëhet një analizë lidhur me numrin dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. (Evidenca 5.9, Evidenca 2.4, Evidenca 5.6),			
Konkluzione	Grupi i vlerësimit të Jashtëm konstaton se Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Rregullorja USH inkurajon marrjen pjesë të studenteve në të gjitha proceset e vendimmarrjes së Universitetit, ku këshillat e studentëve kanë të drejtë të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e USH-së dhe njësisive kryesore si edhe të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve. (Evidenca I), (Evidenca XXXII), (Evidenca XXXIII), (Evidenca L).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët kanë të drejtën e tyre të japin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet fokus grupeve që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. (Evidenca II), (Evidenca L), (Evidenca 6.1), (Evidenca 6.2), (Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Rregullorja e USH parashikon të gjitha, përfshirjen e studentëve në struktura të rëndësishme të vendimmarrjes me qëllim dhënien e kontributit të tyre në rritjen e cilësisë së vazhdueshme të programeve të studimit. Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale përveç procesit të mentorimit gjatë takimeve të të cilit diskutohet ecuria e studentëve apo pyetjet e ndryshme që mund të kenë studentët, gjithashtu diskutohen mundësitë për përmirësimin e programeve duke mbajtur parasysh shqetësimet dhe sugjerimet e studentëve. Diskutimet mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit realizohen gjithashtu nga secili lektor në auditor. Kontributi i studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve studimore konsiderohet i rëndësishëm dhe i vlefshëm. (Evidenca II), (Evidenca L), (Evidenca 6.1), (Evidenca 6.2), (Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4).
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve,	Në Rregulloren e Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Rregulloren e Fakultetit si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti në nenin

<p>përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>21, pika 13 të rubrikës Provimi i kursit. Sipas këtij neni studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Për këtë duhet ti drejtohet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimeve. Ai bënë verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen i drejtohet dekanit. Ky i fundit brenda 48 orëve ngre një komision ad hoc i cili bënë verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratimin e dekanit komisioni bënë vlerësimin përfundimtar Në kuadër të transparencës në proceset vlerësuese, (Evidenca 6.6) (Evidenca II), (Evidenca 1.3), (Evidencë 3.14) (Evidenca I),.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Statuti dhe Rregullorja e Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër parashikojnë procedurën që ndjek institucioni për informimin e studenteve. Sekretaritetë mësimore dhe mekanizat e tjerë institucionalë funksionojnë në këtë drejtim në varësi të kërkesës së studentit. (Evidenca 2.3).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Po ashtu, Universiteti, nëpërmjet Fakultetit të Shkencave të Edukimit me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe t'i ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) për studentët. (Evidenca 2.3), (Evidenca XLI), (Evidenca XLII).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me institucione publike apo njësi biznesi për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.</p>

të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjithashtu në këtë kuadër ky sektor, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat statistikore por nga takimi me studentet doli qe ata nuk e njihnin shume mire rolin e saj. Grupi i vlerësimit të jashtëm sygjeron promovimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës në të gjithë universitetin (Evidenca 5.8), (Evidenca XLI), (Evidenca XLII).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit Në website të Universitetit ka një rubrikë për regjistrimin e ish-studentëve nga ku sigurohet informacion i detajuar për Alumnin. Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale merr informacion çdo vit akademik nga zyra e Karrierës mbi pasurimin e kësaj database. (Evidenca XLI), (Evidenca XLII), (Evidenca 5.7), (Evidenca 5.9), (Evidenca 5.10).			
Konkluzione	<i>Grupi i vlerësimit të jashtëm evidenton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Grupi i vlerësimit të jashtëm sygjeron promovimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në të gjithë universitetin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucionit i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka si objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme ne mbështetje te Rregullores së NJBSC. GVJ konstaton se ka përpjekje për vlerësimin e performancës dhe aktualisht po punohet për finalizimin e strukturës së matjes së performancës së stafit akademik në Institucion, Fakulteti i

	<p>Shkencave të Edukimit inkurajon trajnimet e personelit akademik në kualifikime të ndryshme: konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime brenda dhe jashtë vendit, mësimdhënien në universitetet perëndimore, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat e mundshme, trajnimet nëpërmjet projekteve etj (Evidenca 3.9, Evidenca 2.9, Evidenca 3.7)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstaton ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe të praktikave profesionale, procesin e kontrollit të dijeve, diplomimit, si dhe të veprimtarive administrative dhe financiare.</p> <p>Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit është ngritur NjBSC-ja e Fakultetit. GVB-të përkatëse, cdo vit hartojnë raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin program studimi. Këto raporte diskutohen dhe miratohen në departament.</p> <p>(Evidenca 6.1)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p><i>Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, dekanati, me Vendim Nr.61, datë 06.11.2020, ka miratuar një pyetësor për të marrë mendimet e studentëve të sapodiplomuar. Të dhënat e përfuara analizohen dhe hartohet relacioni përkatës, i cili diskutohet dhe miratohet në dekanat. GVJ u informua nepermjet takimeve që nuk ka një vlerësim për secilin pedagog dhe për secilën lëndë.</i></p> <p><i>GVJ rekomandoi dekanin dhe shefin e departamentit si mund të bashkëpunohet me NJSBC-në, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për hartimin e pyetësorëve specifikë, të cilët shërbejnë për matjen e performancës së pedagogut.</i></p> <p><i>Studentët kanë të drejtë të shprehin ankesat dhe sugjerimet e tyre në mbledhjet e hapura të departamentit, pranë Përgjegjësit të Departamentit, Dekanit dhe autoriteteve të tjera drejtuese apo nëpërmjet diskutimeve të vazhdueshme që ato zhvillojnë.</i></p> <p>(Evidenca 6.1) (Evidenca 6.2), (Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4),</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me pedagogët shprehen se gjatë konsultimeve që zhvillojmë me studentet janë gjithmonë të vëmendshëm që të tërheqim mendimin e studentëve në lidhje me programin mësimor, mësimdhënien, lidhjen e teorisë me praktikën si përforcuese e asaj që mësohet teorikisht.</p> <p>Në hartimin e raporteve për vlerësimin e brendshëm për secilin program studimi marrin pjesë të gjithë anëtarët e departamenteve, duke filluar që nga përgjegjësi i departamentit, i cili ndihmon me mendimet dhe shkresat përkatëse, duke vazhduar me mendimet e studentëve dhe të ekspertit të jashtëm.</p> <p>Gjithashtu, edhe sekretaria mësimore dhe e dekanit japin evidencat e kërkuara. RVB-të e hartuara kalojnë për miratim në departamentet përkatëse dhe më pas në Dekanat. Pasi miratohen në Dekanat, përcillen në Rektorat.</p> <p>(Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4), (Evidenca X).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon</p>	<p>Gjatë takimit me pedagogët e Departamentit, GVJ doli në përfundim se të dhënat e përfuara nga mekanizmat e vlerësimeve periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës dhe</p>

shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	identifikimin e problemeve, por ka si synim kryesor marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara janë marrë masa të cilat variojnë nga zhvillimi i bashkëbisedimeve për promovimin e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe deri tek diskutimet për shmangien problematikave të evidentuara. (Evidenca 6.5).			
Konkluzione	GVJ në mbështetje të dokumentacionit të dorëzuar, si edhe duke iu përmbajtur diskutimeve të realizuara me Drejtuesin e Departamentit, pedagogët, studentët konstaton se në kuadër të garantimit dhe promovimit të cilësisë së mësimdhënies funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila përpaket të vlerësojë periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, por GVJ u informua nëpërmjet takimeve që nuk ka një vlerësim për secilin pedagog dhe për secilën lëndë GVJ rekomandoi dekanin dhe Drejtuesin e Departamentit për bashkëpunimin e stafit akademik me NJSBC, mungesën e formalizimit dhe hartimin e pyetësorëve specifikë, të cilët shërbejnë për matjen e performancës së pedagogut dhe lëndës, përditësimin e kurrikulës, specifikimin e faqeve të literaturës në fund të Syllabusit dhe bashkëpunimin më të ngushtë me ALUMNI, jo vetëm me institucionet ku ata janë të punësuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër zbaton politika, ka struktura dhe ndjek procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore që ka ajo vetë. Njëkohësisht, duke hartuar një politikë të qartë Universiteti ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër në zbatim të ligjit për arsimin e lartë si dhe në zbatim të Statutit të tij ka ngritur “Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në Institucion dhe Programeve të Studimit” (KGSCPS), si dhe Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve, e ngritur në vitin 2015. Komisioni i përhershëm i garantimit të standardeve të cilësisë së Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe programeve të studimit e realizon punën e tij duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja e KGSCPS.

	<p>Gjithashtu, në nivel të njësisë kryesore u konstatua që Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka ngritur dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Evidenca I), (Evidenca II), (Evidenca XIV), (Evidenca XV), (Evidenca 6.1).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër në zbatim të ligjit për arsimin e lartë si dhe në zbatim të Statutit të tij ka ngritur “Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në Institucion dhe Programeve të Studimit” (KGSCPS), si dhe Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit shkencor dhe Standardeve, e ngritur ne vitin 2015.</p> <p>Komisioni i përhershëm i garantimit të standardeve të cilësisë së USH dhe programeve të studimit e realizon punën e tij duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja e KGSCPS. Gjithashtu, në nivel të njësisë kryesore u konstatua që FSHE ka ngritur dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Evidenca I), (Evidenca II), (Evidenca XIV), (Evidenca XV), (Evidenca 6.1).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Ky program studimi, nuk i është nënshtruar akreditimeve të mëparshme.</p> <p>DPPS raporton përmes RVB-së së programeve të studimit në mënyrë të përvitshme. Vlerësimet e brendshme kryhen në mënyrë periodike nga departamentet dhe dekanati dhe shërbejnë për të përmirësuar cilësinë (Evidenca X).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>GVJ, pas të dhënave të marra nga dokumentacioni i paraqitur, diskutimet me pedagogët, studentët konstaton se DPPS realizon çdo vit akademik analizën e punës mësimore-shkencore të departamentit ku raporton mbi ecurinë e një viti akademik në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor të stafit të tij.</p> <p>Në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër që nga viti 2015 është ngritur një kulturë e sigurimit të cilësisë ku çdo vit akademik secili departament harton raportet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimit që ofron si dhe në fund të çdo viti Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit shkencor dhe Standardeve prezanton në Senatin akademik të Universitetit, Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Universitetit, gjithashtu prej dy vitesh secili Fakultet harton Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Fakultetit. (Evidenca I), (Evidenca II), (Evidenca 6.1), (Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Nisur nga dokumentacioni referues, si edhe nga takimet e drejtpërdrejta me aktorët, GVJ arrin në përfundimin se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të</p>

	<p>studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Kjo realizohet konkretisht nëpërmjet ngritjes së NJSBC, misioni i së cilës është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim.</p> <p>GVJ rekomandon të shtohet stafi në Njësinë për kërkimin shkencor duke parë rëndësinë e tij edhe në nivel departamenti.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të shumta dhe të ndryshme rreth programeve arsimore, me qëllimin e përmirësimit të mësimnxënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve akademike dhe të mësimdhënies.</p> <p>Institucioni ka përdorur rregullisht një sërë mekanizmash dhe procesesh formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit. Ndërgjegjësimi i personelit akademik dhe I studentëve në lidhje me rëndësinë e cilësisë në programin e studimit është diskutuar në mbledhjet e departamentit si edhe me studentët. (Evidenca 2.11 dhe Evidenca 3.6).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në mbështetje të dokumentacionit të dorëzuar, rezultojnë se vlerësimet që bëhen nga Analiza Vjetore dhe nga Vlerësimet e Brendshme të Departamentit dhe të Fakultetit, ku përfshihet dhe ky program studimi, analizojnë rezultatet pikërisht duke i krahasuar me atë çfarë ishte planifikuar.</p> <p>Raportet analitike dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësime të mëtejshme të cilësisë. Formati i raporteve të vlerësimit të brendshëm përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit. Çdo raport i përdorur nga USH për matjen e Sigurimit të brendshëm të cilësisë, si në nivel institucional dhe programi studimi bazohet në raportet template të afishuara në faqen zyrtare të ASCAL. (Evidenca 6.3 dhe Evidenca 6.4).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me pedagoget, Drejtuesin e Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale, si edhe studentet se në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të ndryshme.</p>

<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Ndër metodat të drejtpërdrejta të përdorura nga FSHE, DPPS përfshijnë vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve</p> <p>Në këtë kuadër realizohen një sërë masash siç janë mbledhjet e vazhdueshme në nivel departmenti, vlerësimi paraprak i provimeve, raporti përmbledhës nga drejtuesi i njësisë bazë etj Gjithashtu lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të dhe dosjet e tyre të vlerësimit të cilat i disponojnë të gjithë shefat e departamenteve dhe tek burimet njërezore.</p> <p><i>(Evidenca I), (Evidenca X), (Evidenca XVI), (Evidenca XIX), (Evidenca 6.2), (Evidenca 6.3)</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë ka përfshirja e studentëve në këtë proces dhe i grupeve të tjera të interesit. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se departamenti duhet të punojë për plotësimin e këtij kriteri.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëngjitur RVB, pas takimeve të drejtpërdrejta me pedagogët, studentët, apo struktura të tjera përgjegjëse, arriti në konkluzionin FSHE monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p> <p><i>Konkretisht, Departamenti dhe Fakulteti kryejnë analizat vjetore dhe vlerësimin e brendshëm në përputhje me mekanizat rregullues të universitetit. Por duhet të përfshijnë një nga metodat më të rëndësishme atë të pyetësorëve të studentëve lidhur me vlerësimet për pedagogët dhe lëndën gjithashtu edhe me studentët alumni.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="628 1688 804 1783">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="804 1688 1043 1783">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1043 1688 1257 1783">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1257 1688 1407 1783">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka parashikuar dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit. FSHE, DPPS garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit Në USH është i rëndësishëm angazhimi i studentëve në çdo nivel të vendimarrjes. Nga departamenti nuk kishte asnje student përfaqësues të studentëve ne organet kolegjale. <i>(Evidenca X), (Evidenca XVI), (Evidenca XIX).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në strukturat e ngritura për Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër nëpërmjet Rregulloreve të posaçme për këtë qëllim ka përcaktuar përgjegjësitë e detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe pale të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca I), (Evidenca X).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e departamenteve dhe FSHE, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik dhe studentët e programit të studimit. <i>(Evidenca I), (Evidenca X), (Evidenca B), (Evidenca 1.3).</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Rregullorja dhe statuti i USH garantojnë integritetin akademik dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve. Ato garantojnë një pjesëmarrje të drejtë të personelit akademik e të studentëve në këtë proces. Përzgjedhja e personelit për këtë proces bazohet në kontributin, seriozitetin dhe integritetin akademik. Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. <i>(Evidenca I), (Evidenca X), (Evidenca B), (Evidenca 1.3).</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ konstaton se GVB është e përbërë vetëm nga anëtarë të brendshëm të departamentit dhe një student. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët FSHE bashkëpunon është një rekomandim për departamentit në mënyrë që të ketë mundësi në marrjen e opinionëve që përmirëson cilësinë e këtij programi studimi. Vlerësimi i bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit mund të merrret gjatë organizimit të takimeve apo konferencave të ndryshme.</p>

Konkluzione	<i>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si edhe pas shkëmbimeve me stafin akademik dhe studentët, doli në konkluzionin se FSHE përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndyshëm, me të cilët Fakulteti i Shkencave të Edukimit bashkëpunon është një rekomandim për departamentit në mënyrë që të ketë mundësi në marrjen e opinionëve që përmirëson cilësinë e këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen e internetit të institucionit gjenden të publikuara informacione të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e NJSBC. Nga takimet e drejteperdrejta me studentet, GVJ konstatoi se për grupet e reja të studentëve realizohet java informuese, ku studentët informohen nga lektorët e departamentit në lidhje me funksionimin dhe organizimin e çdo programi studimi. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. <i>(Evidenca I), (Evidenca X), (Evidenca 1.3), (Evidenca 6.1).</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër në mënyrë periodike realizon takime dhe aktivitete me qëllim njohjen me rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit. Këto takime kanë formën e diskutimeve dhe bashkëbisedimeve mbi materialet finale të raporteve të vetëvlerësimit. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e USH. Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë dhe nuk ka evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi çënimin e lirisë për të dhënat personale Programi në fjalë është në procesin e akreditimit për herë të parë. <i>(Evidenca I), (Evidenca II), (Evidenca XIX), (Evidenca XXXV) (Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4).</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjise dhe Punës Sociale si edhe ky program studimi nuk i janë nënshtruar një vlerësimi të mëparshëm të procesit të akreditimit.



përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Vlerësimet dhe analizat e realizuara identifikojnë nevojat për përmirësime të mëtejshme. Stafin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit angazhohen që të marrin masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara (Evidenca I), (Evidenca II), (Evidenca X), (Evidenca XIX), (Evidenca 6.3), (Evidenca 6.4).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	FSHE analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Produkti i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL-së që dorëzohet në MAS. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre. GVJ mendon që krahas këtyre raporteve NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimet me stafin akademik të DAP, GVJ konstaton se NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë. DPPS me anë të veprimtarive periodike si "Ditët e hapura", sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, realizon shumë mirë informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. (Evidenca I), (Evidenca II), (Evidenca X).			
Konkluzione	GVJ pas hulumtimit të dokumentacionit mbështetës, pas takimeve me aktorët përgjegjës konstatoi se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: "Psikologji" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër ka eksperiencë të gjatë në Arsimin e Lartë. Kjo bën që të ketë një kulturë më të gjerë pune dhe një njohje më të thelluar në të gjitha fushat.
2. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër ka një listë të gjatë bashkëpunëtorësh kombëtarë që ka një përfitim të dyfishtë: nga njëra anë, lehtëson lidhjen teori – praktikë të programit, nga ana tjetër praktikat që studentët ndjekin bëhen realisht në institucione nga ku përfitojnë aftësi dhe shkathtësi të aplikueshme drejtpërdrejt në terren.
3. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor për programin e studimit.
4. Staffi akademik dhe ai administrativ janë në mbështetje të studentëve dhe shumë pranë tyre.
5. Respektimi i kërkesave të legjislacionit parësor dhe dytësor për hartimin, organizimin dhe ofrimin e këtij programi studimi. Programi është konceptuar dhe administruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe pedagogjike.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e mobilitetit të studentëve nga programi i studimit Bachelor në "Psikologji" drejt programeve të ngjashme në universitete jashtë vendit dhe anasjelltas.
2. Praktikrat e sigurimit të cilësisë nuk mbërrijnë në nivel programi dhe nuk vlerësojnë aftësitë mësimdhënëse dhe formimin e personelit akademik të angazhuar në nivel programi.
3. Plani mësimor kërkon një rishpërndarje më funksionale të orëve dhe krediteve duke ruajtur një peshë më të balancuar për secilën lëndë, në mënyrë që studentët të përfitojnë nga të gjitha disiplinat në fushën e psikologjisë.
4. Mungesë e literaturës së fundit dhe bashkëkohore në fushën e psikologjisë. Librat janë të vjetër dhe mungojnë tituj të rinj në këtë disiplinë.
5. Mungesa e evidencave të përmirësimit dhe përditësimit të përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme si në elementët e planit mësimor të programit të studimit edhe në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve dhe moduleve të ofruara në programin e studimit
6. Praktika mësimore për studentët nuk është në përputhje me udhëzimet e fundit. Aktualisht praktika është e organizuar në program si Praktikum dhe parashikon orë seminari në auditor

Rekomandime:

1. Institucioni të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Psikologji", në mënyrë që të ketë tregues të studentëve përfitues nga programet e shkëmbimit.
2. Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, rekomandohet të konsiderojë përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme sipas objektivave strategjike të zhvillimit të departamentit dhe të programit të studimit, duke ruajtur një shpërndarje dhe peshë thuajse të njëjtë në orë dhe kreditë.
3. Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, rekomandohet të riorganizojë praktikën profesionale për studentët në mënyrë që të jetë në përputhje me udhëzimet e fundit. Aktualisht praktika është e organizuar në program si Praktikum dhe parashikon orë seminari në auditor. Ndërkohë GVJ rekomandon që praktika të zhvillohet në institucionet me të cilat Universiteti I Shkodrës ka marrëveshje bashkëpunimi.
4. Të hartohen dhe të implementohen politika të qarta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në mënyrë që procesi të shërbejë përmirësimin të cilësisë nëpërmjet strategjive të ndërhyrjes.
5. Të përditësohet literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj për fushën e psikologjisë, në mënyrë që studentët të kenë më shumë akses për të lexuar.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Psychology" provided by the Higher Education Institution University "Luigj Gurakuqi" of Shkodra

Strengths and affirmations

1. **The University "Luigj Gurakuqi" of Shkodra has a long experience in Higher Education.** This leads to a broader work culture and deeper knowledge in all areas.
2. **The University "Luigj Gurakuqi" of Shkodra has a long list of national collaborators** which has a double benefit: on the one hand, it facilitates the theory-practice connection of the program, on the other hand, the practices that students follow are actually done in institutions from which they benefit from skills and abilities that can be applied directly in the field.
3. **University "Luigj Gurakuqi" of Shkodra has clear and effective policies of increasing partnerships and cooperation with institutions, companies, third parties, domestic and/or foreign business actors in order to realize the study program, within the framework of professional training, professional practices and scientific research for the study program.**
4. **Academic and administrative staff** are in support of the students and very close to them.
5. **Compliance with the requirements of primary and secondary legislation** for the design, organization and delivery of this study program. The program is designed and administered in accordance with legal and pedagogical requirements.




Weaknesses

1. Lack of student mobility from this study program to similar programs at universities abroad and vice versa.
2. Quality assurance practices do not reach the program level and do not assess the teaching skills and training of academic staff engaged at the program level.
3. The curriculum requires a more functional redistribution of hours and credits while maintaining a more balanced weight for each subject, so that students benefit from all disciplines in the field of psychology.
4. Lack of recent and contemporary literature in the field of psychology. The books are old and there is a lack of new titles in this discipline.
5. Lack of evidence of continuous improvement and updating of the content of the study program both in the elements of the curriculum of the study program and in the content of the syllabuses of the subjects and modules offered in the study program
6. Teaching professional practice for students is not in accordance with the latest guidelines. Currently, the practice is organized in the program as Praktikum and foresees seminar hours in the auditorium

Recommendation

1. The institution should work more towards promoting the mobility of students of the "Bachelor" study program in "Psychology", so that there are indicators of students benefiting from exchange programs.
2. The Department of Psychology and Social Work is recommended to consider improving and updating the content of the study program on an ongoing basis according to the strategic objectives of the development of the department and the study program, maintaining an almost equal distribution and weight in hours and credits.
3. The Department of Psychology and Social Work is recommended to reorganize the professional practice for students in order to comply with the latest guidelines. Currently, the practice is organized in the program as Praktikum and foresees seminar hours in the auditorium. In the meantime, GVJ recommends that the internship be developed in the institutions with which the University of Shkodra has a cooperation agreement.
4. To design and implement clear policies for the evaluation of the quality of the study program and of the academic staff engaged in the study program so that the process serves to improve quality through intervention strategies.
5. To update the literature in Albanian and foreign languages for the field of psychology, so that students have more access to read it.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II.				
III. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
IV. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
V. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VI. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VII. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X



